



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development  
*Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë / Agencija za Razvoj Poloprivrede /*  
*Agriculture Development Agency*

**THIRRJE PËR APLIKIM**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural fton të gjithë fermerët e interesuar që të aplikojnë për mbështetje përmes Programit për Pagesa Direkte për vitin 2026.

Programi i Pagesave Direkte 2026, këtë vit ka një dizajnim të ri të mbështetjes duke u bazuar në harmonizimin gradual me politikat e Bashkimit Evropian dhe me parimet e Politikës së Përbashkët Bujqësore edhe atë:

1. Pagesa Bazë për të Ardhura (PBA)
2. Pagesat Rishpërndarëse
3. Pagesat e lidhura me Prodhimin e kulturave prioritare dhe cilësinë
4. Pagesat për Eko-Skemat

**Periudha e aplikimit:**

Aplikimi zgjatë 30 ditë kalendarike dhe fillon që nga dita e shpalljes publike, nga data **22.06.2026** dhe përfundon më datë **21.07.2026, në ora 16:00.**

## 1. PAGESA BAZË PËR TË ARDHURA -SIPËRFAQE

Jepet për sipërfaqe të pranueshme të tokës bujqësore për kulturat:

<b>Produkti</b>	<b>Njësia</b>
<i>Grurë, farë gruri, misër, elb, tërshërë dhe thekër</i>	Hektar
<i>Lulediell, kunguj misiri</i>	Hektar
<i>Fasule, patate</i>	Hektar
<i>Perime në fushë të hapur dhe serra</i>	Hektar
<i>Pemë drufrutore, arvore dhe manore</i>	Hektar
<i>Të gjitha sipërfaqet me hardhi rrushi</i>	Hektar

## 2. PAGESAT RISHPËRNDARËSE

Pagesat rishpërndarëse përfshijnë dy komponente kryesore: Komponenti i parë është mbështetja për hektarët e parë të fermës, e cila mbështetje sigurohet për hektarët e parë të fermës brenda brezit 0 deri 0.99 hektar, dhe komponenta e dytë është mbështetje për fermerët e rinj dhe të regjistruar për herë të parë, (deri në moshën 29 vjet, që deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 30 vite).

<b>Skema / Brezi</b>
<b>0 – 0.99 ha</b>
<b>Fermerët e rinjë (18-29), që deri në ditën e aplikimit nuk i ka mbushur 30 vite.</b>

### 3. PAGESAT E LIDHURA ME PRODHIMIN E KULTURAVE PRIORITARE DHE CILËSINË

Nr.	Produkti	Njësia
1.1	Lopë qumështore	kokë
1.2	Mëshqerra për riprodhim	kokë
1.3	Buallica	kokë
2.1	Dosa për riprodhim	kokë
3.1	Pula	kokë
4.1	Dele për mbarështim	kokë
4.2	Dhi për mbarështim	kokë
5.1	Koshere bletësh	koshere
7.2	Mbështetje shtesë misër	ha
7.3	Mbështetje tjetër - fara e grurit	ha
8.1	Pemë drufrutore, arnore, manore	ha
8.2	Pemë në serrë	ha
8.2	Mjedra	kg
9.1	Material fidanor i pemëve	copë
10.1	Material fidanor - Fidanë vreshta	copë
10.2	Vreshta	ha
10.3	Verë e prodhuar	litër
11.1	Perime (serra)	ha
11.2	Perime (fushë e hapur)	ha
11.3	Patate	ha
11.4	Fasule	ha
12.1	Luledielli	ha
13.1	Bimë mjekësore & aromatike	ha

### 1.3. Eko-Skema:

Nr.	Produkti	Njësia
1.1	Bletë organike	koshere
2.1	Grurë organik	ha
3.1	Pemishte ekzistuese	ha
3.2	Aronia (në konvertim)	ha
4.1	Luledielli (në konvertim)	ha
5.1	Bimë mjekësore & aromatike	ha
5.2	Bimë mjekësore & aromatike (konvertim)	ha

#### Mënyra e aplikimit:

Aplikimi për Pagesa Direkte bëhet në zyrat e Drejtorive Komunale për Bujqësi.

Aplikuesi / fermeri pas aplikimit dhe para realizimit të kontrollit në teren, në rast se ka ndryshime në fermën e tij për sipërfaqet, numrin, litrat, kg dhe krerët e deklaruara gjatë aplikimit, duhet të informojë AZHB-në në adresën elektronike **pd.azhb@rks-gov.net** ose me shkresë të protokolluar në arkivin e AZHB-së. Afati i fundit për informimin, në rast se ka ndryshime në fermën e tij për sipërfaqet, është data 30.07.2026.

Gjatë kontrollit në terren, në rast të gjetjes së parregullsive, do të aplikohen masa ndëshkimore duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.02/2026 për Pagesa Direkte në Bujqësi për vitin 2026.

Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet i kompletuar brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar nuk do të pranohet për shqyrtim.

Informatat më të hollësishme mund të merren në web faqen e MBPZHR-se, **[www.mbpzhr-ks.net](http://www.mbpzhr-ks.net)** dhe në web faqen e AZHB-se, **[www.azhb-ks.net](http://www.azhb-ks.net)**, si dhe në Drejtoritë Komunale për Bujqësi.

**DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM - TË GJITHË APLIKUESIT SI PERSONA  
JURIDIK DUHET TË DORËZONJË EDHE:**

- Kopje të certifikatës së regjistrimit të biznesit – ARBK (vetëm për personat juridik);
- Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së (vetëm për personat juridik);
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të aplikuesit (vetëm për personat juridik);
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës, e aplikuesit - pronarit të biznesit (vetëm për personat juridik);

Fermerët/aplikuesit, që përfitojnë subvencion në vlerë/shumë mbi 30,000 €, duhet të aplikojnë si biznes.

Fermerët që janë përfitues të Pagesave Direkte - persona juridikë duhet të regjistrohen edhe si furnitorë në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK) përmes platformës e-Kosova. Ky regjistrim është i nevojshëm për procesimin e pagesave.

**DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM DHE KRITERET PËR APLIKIM SIPAS  
KULTURAVE QË DO TË MBËSHTETEN ME PROGRAMIN E PAGESAVE DIREKTE  
PËR VITIN 2026:**

**1. Pagesat direkte për sipërfaqet e mbjella me drithëra: grurë, grurë për farë, elb, thekër, tërshërë, misër**

**Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:**

- Të kenë të mbjellë së paku **1 ha** me grurë ose elb ose thekër ose tërshërë ose misër;
- Parcela e mbjellë, me cilin do prej drithërave (grurë ose elb ose thekër ose tërshërë ose misër) duhet të jetë së paku **0.20 ha** e pandarë;
- Të kenë të mbjellë së paku **5 ha** me grurë për prodhimin e farës;
- Të posedojnë kontratën e lidhur në mes të dy palëve (fermerit/aplikuesit dhe kompanisë prodhuese të farës);
- Parcela e mbjellë me grurë për farë duhet të jetë së paku **1 ha** e pandarë;

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Deklarata nën betim, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.
- Kontratën e lidhur në mes të dy palëve (fermerit/aplikuesit dhe kompanisë prodhuese të farës);
- Dëshmi mbi kategorinë e farës së grurit të mbjellë;
- Raporti i Inspektoratit fito sanitar - AUV nga inspektimet fushore për farë të grurit I dhe II (ky dokument duhet të dorëzohet pasi të realizohen inspektimet fushore);

## **2. Pagesat direkte për sipërfaqet e mbjellura me luledielli**

### **Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:**

- Të kenë të mbjellë së paku **1 ha** me luledielli;
- Parcela e mbjellë me luledielli, duhet të jetë së paku **0.20 ha** e pandarë;

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Deklarata nën betim, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.

## **3. Pagesat direkte për sipërfaqet e mbjella me perime**

### **Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:**

- Të kenë të mbjellë së paku **0.30 ha** me perime në fushë të hapur
- Parcela e mbjellë me perime në fushë të hapur duhet të jetë së paku **0.20 ha** e pandarë;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.10 ha** me perime në fushë të hapur
- Parcela e mbjellë me perime në ambiente të mbrojtura (serra) duhet të jetë së paku **0.05 ha** e pandarë;

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Deklarata nën betim, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.
- Kontrata e lidhur me ndonjëren nga kompanitë që realizojnë grumbullimin dhe përpunimin e kungullit (vlen vetëm për fermerët që kultivojnë kungull me sipërfaqe mbi 2 ha)
- Dëshmi për sasinë e kungujve të shitur në ndonjëren nga kompanitë që realizojnë grumbullimin dhe përpunimin e kungullit. (Ky dokument duhet të silllet/dorëzohet pas përfundimit të sezonës së vjeljes dhe shitjes të kungujve, dhe vlenë vetëm për fermerët që kultivojnë kungull me sipërfaqe mbi 2 ha)

- Dëshmi e pagesës nga banka për sasinë e kungujve të shitur. (Ky dokument duhet të sillet-dorëzohet pas përfundimit të sezonës së vjeljes dhe shitjes të kungujve, dhe vlenë vetëm për fermerët që kultivojnë kungull me sipërfaqe mbi 2 ha)

#### **4. Pagesat direkte për vreshta**

##### **Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:**

- Të kenë të mbjellë së paku **0.10 ha** me vreshta;
- Parcela e mbjellë me vreshta duhet të jetë së paku **0.05 ha** e pandarë;
- Të jenë të regjistruar në kadastrën e vreshtave në DVV - MBPZHR;
- Vreshti duhet të jetë i mirëmbajtur (i lëvruar në mes të rreshtave ose me bari të kultivuar në mes të rreshtave, krasitur, mbrojtur nga sëmundjet dhe dëmtuesit) dhe sistemi i mbjelljes të jetë me renditje të qartë dhe të rregullt të rendeve/rreshtave;

##### **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Deklarata nën betim, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.
- Dëshmi nga kadastri i vreshtave mbi sipërfaqen e vreshtit - certifikata e vreshtit e lëshuar nga Departamenti i Vreshtarisë dhe Verërave - MBPZHR

#### **5. Pagesat direkte për verën e prodhuar dhe të deklaruar zyrtarisht**

##### **Kriteret që duhet t'i plotësojnë kompanitë prodhuese të verës:**

- Aplikuesit/subjektet duhet të jenë të licencuar në MBPZHR për prodhimin e verërave;
- Aplikuesit/subjektet duhet që deri më datë 10 Dhjetor 2025 në Departamentin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë të deklarojnë të dhënat për deklarimin përfundimtar të vjeljes së rrushit për vjeljet e vitit 2025;
- Aplikuesit/subjektet duhet që deri më datë 15 Janar 2026, në Departamentin e Vreshtarisë dhe Verëtarisë, të deklarojnë të dhënat e prodhimit vjetor të verës për vjeljet e vitit 2025.

##### **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Dëshmi për sasinë e rrushit të pranuar nga fermerët (vlenë për të gjitha kompanitë prodhuese të verërave-bodrumet);

- Dëshmi për sasinë e rrushit të prodhuar (vlenë vetëm për kompanitë prodhuese të verërave-bodrumet, të cilat posedojnë sipërfaqe të mbjella me vreshta).

## **6. Pagesat direkte për pemishtet ekzistuese**

### **Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:**

- Të kenë të mbjellë së paku **0.50 ha** me pemë drufrutore;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.20 ha** me pemë të imëta (mjedër, dredhëz, manaferrë, aroni, boronicë dhe rrush serezi) në fushë të hapur ose në serrë;
- Parcela e mbjellë me pemë drufrutore duhet të jetë së paku **0.20 ha** e pandarë;
- Parcela e mbjellë me pemë të imëta (dredhëz, manaferrë, aroni boronicë dhe rrush serezi), në fushë të hapur ose në serrë, duhet të jetë së paku **0.05 ha** e pandarë.
- Pemishtja duhet të jetë e mirëmbajtur (e lëvruar ose me bari të kultivuar në mes të rreshtave, krasitur, mbrojtur nga sëmundjet dhe dëmtuesit) dhe sistemi i mbjelljes të jetë me renditje të qartë dhe të rregullt të rendeve/rreshtave;

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Deklarata nën betim, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.
- Kontrata e lidhur me ndonjërin nga kompanitë/pikat grumbulluese që realizojnë grumbullimin e mjedrës
- Dëshmia për sasinë e frutave të mjedrës të shitur në ndonjërin nga pikat grumbulluese. (Ky dokument duhet të sillet/dorëzohet pas përfundimit të sezonës së vjeljes së frutave të mjedrës dhe shitjes në pikat grumbulluese, më së largu me 30 nëntor)
- Dëshmia e pagesës nga banka për sasinë e frutave të mjedrës të shitur. (Ky dokument duhet të sillet/dorëzohet pas përfundimit të sezonit të vjeljes së frutave të mjedrës dhe shitjes në pikat grumbulluese dhe pas realizimit të pagesave për sasinë e shitur të frutave të mjedrës nga pikat grumbulluese në xhirollogari të fermerëve, më së largu me 30 Nëntor)

## **7. Pagesat direkte për prodhimin e materialit fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit**

### **Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët / aplikuesit:**

- Fermeri/subjekti duhet të jetë i licencuar në MBPZHR-së ose AUV për prodhimin e materialit fidanor të pemëve;
- Fermeri / subjekti duhet të jete i licencuar në MBPZHR-së ose AUV për prodhimin e materialit fidanor të hardhisë së rrushit;
- Fermeri/subjekti, gjatë vitit kalendarik 2026, duhet të prodhojë së paku 3000 fidanë të pemëve drufrutore ose hardhisë së rrushit;
- Subvencionimi bëhet vetëm për fidanët njëvjeçare.

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Deklarata nën betim, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.
- Kopjen e deklarimit të sasisë së prodhuar të fidanëve për vitin kalendarik 2026, të vërtetuar/nënshkruar dhe vulosur nga Inspektori Fitosanitar - AUV (ky dokument sillet/dorëzohet pasi të kryhet deklarimi i sasisë së prodhuar të fidanëve, më së largu me 30 nëntor);
- Kopja e certifikatës fitosanitare mbi gjendjen shëndetësore të fidanëve të prodhuar në vitin kalendarik 2026 (ky dokument sillet/dorëzohet pas kryerjes së analizave të fidanëve për gjendjen shëndetësore, më së largu me 30 nëntor).

**8. Pagesat direkte për bimë mjekësore aromatike (bma) dhe bimë mjaltë dhënëse**

**Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të mbjellë së paku **0.10 ha** me BMA ose mjaltë dhënëse;
- Parcela e mbjellë me BMA ose mjaltë dhënëse duhet të jetë së paku **0.05 ha** e pandarë;

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Deklarata nën betim, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.

**9. Pagesat direkte për prodhimitari organike dhe konvertim**

**Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:**

- Të kenë të mbjellë së paku **0.10 ha** me kultura bujqësore me qëllim të prodhimit organik;

- Të kenë të mbjellë së paku **0.10 ha** me kultura bujqësore që ndodhen në fazën e konvertimit/kalimit për prodhimtari organike;
- Parcela e mbjellë me kultura bujqësore me qëllim të prodhimit organik duhet të jetë së paku **0.05 ha** e pandarë;
- Parcela e mbjellë me kultura bujqësore që ndodhet në fazën e konvertimit/kalimit për prodhimtari organike, duhet të jetë së paku **0.05 ha** e pandarë;
- Fermerët/aplikuesit, në momentin e aplikimit duhet të deklarojnë se cila kulturë bujqësorë është e mbjellë në parcelën/ngastrën për të cilën aplikojnë;

#### **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Deklarata nën betim, për saktësinë dhe vërtetësinë e sipërfaqes për të cilën aplikojnë dhe e digjitalizojnë në momentin e aplikimit.
- Dëshmia/Certifikata për certifikimin organik ose për fazën e konvertimit/kalimit për prodhimtari organike, për ngastrën dhe kulturën bujqësore të mbjellë në të. Dëshmia lëshohet nga trupa e kontrollit (trupa certifikuese) e akredituar në nivel të BE-së dhe duhet të dorëzohet pasi të realizohet certifikimi organik për ngastrën dhe kulturën bujqësore që është e mbjellë në atë ngastër. (Ky dokument duhet të sillet/dorëzohet më së largu me 30 nëntor);
- Lista e produkteve të certifikuara (aneksi);
- Lista e parcelave, e vulosur nga trupa e kontrollit (trupa certifikuese) e akredituar në nivel të BE-së;

#### **10. Pagesat direkte për lopë dhe buallica qumështore dhe mëshqerra për riprodhim, për delet dhe dhitë, dhe dosat për riprodhim**

##### **Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët / aplikuesit:**

- Të mbarështojnë së paku **5 krerë** lopë qumështore, në kohën/ditën e aplikimit mosha e lopës qumështore duhet të jenë të moshës nga **20 muaj deri në 10 vjet**
- Të mbarështojnë së paku **5 krerë** buallica qumështore, në kohën/ditën e aplikimit, mosha e buallicës qumështore duhet të jenë të moshës nga **20 muaj deri në 10 vjet**
- Të mbarështojnë së paku **5 krerë** mëshqerra për riprodhim, në kohën/ditën e aplikimit - mosha e mëshqerrave për riprodhim duhet të jetë nga **14 muaj deri në 24 muaj**
- Të mbarështojnë së paku **30 krerë** dele qumështore, në kohën/ditën e aplikimit, mosha e kafshëve duhet të jetë nga **12 muaj deri në 7 vjet**

- Të mbarështojnë së paku **20 krerë** dhi qumështore, në kohën/ditën e aplikimit, mosha e kafshëve duhet të jetë **nga 12 muaj deri në 8 vjet**,
- Të mbarështojnë së paku **5 dosa** për riprodhim aktiv në të gjitha fazat e riprodhimit;
- Kafshët duhet të jenë të matrikuara me matrikulë të Republikës së Kosovës ose shteteve të BE-së;
- Kafshët duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara në sistemin e Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV;
- Numri i kafshëve në fermë dhe në bazën e të dhënave duhet të jetë i përditësuar;

#### **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Regjistri për vitin 2026 i lëshuar nga Praktikrat veterinarë të kontraktura ose të autorizuara nga AUV, duke u bazuar në të dhënat e sistemit të Identifikimit dhe Regjistrimit të kafshëve në AUV

#### **11. Pagesat direkte për bletë/ bletë organike**

##### **Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët / aplikuesit:**

- Të mbarështojnë së paku 30 shoqëri bletësh (koshere), me përjashtim të nukleusit;
- Fermerët që kanë 30 deri 100 shoqëri bletësh (koshere) mund t'i kenë të vendosura shoqëritë e bletëve (kosheret) maksimumi në dy (2) bletishte, fermerët që kanë mbi 100 deri 200 shoqëri bletësh (koshere) mund t'i kenë të vendosura shoqëritë e bletëve (kosheret) maksimumi në tri (3) bletishte, fermerët që kanë mbi 200 deri 400 shoqëri bletësh (koshere) mund t'i kenë të vendosura shoqëritë e bletëve (kosheret) maksimumi në katër (4) bletishte, fermerët që kanë mbi 400 shoqëri bletësh (koshere) mund t'i kenë të vendosura shoqëritë e bletëve (kosheret) maksimumi në shtatë (7) bletishte;
- Fermerët aplikues, në bletishten bazë duhet të kenë së paku 30 shoqëri bletësh, ndërsa në bletishte tjera duhet të kenë së paku 15 shoqëri bletësh;
- Kosheret duhet të jenë të shënuara qartë me Numrin Identifikues të Fermës (NIF), me ngjyrë të përhershme/permanente, sipas standardit me dimensione 30 x 12 cm;
- Kosheret duhet të posedojnë së paku gjashtë (6) korniza;
- Në momentin e kontrollit të fermerit / aplikuesit, në rast se i mungon numri Identifikues i Fermës (NIF) në koshere, atëherë përjashtohet nga subvencionimi secila koshere pa numrin Identifikues të fermës (NIF) të shënuar.

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Dëshmi individuale nga ana e vet fermerit për numrin e shoqërive të bletëve dhe vendndodhjen e shoqërive të bletëve, e cila duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga Drejtoria Komunale përkatëse për Bujqësi - Komuna
- Përfituesi duhet të paraqesë certifikatë valide për bletari organike, të lëshuar nga organet kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**12. Pagesat direkte për pula vojse****Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët / aplikuesit:**

- Të mbarështojnë së paku **500 pula vojse** në të gjitha fazat e prodhimit aktive të vezëve;
- Aplikuesi/subjekti duhet të jetë i regjistruar në AUV;
- Në kohën/ditën e realizimit të kontrollit në teren, mosha e pulave vojse duhet të jetë 16 javëshe, por jo më shumë se 95 javësh;
- Aplikuesi/subjekti duhet të aplikojë programin e vaksinimit;
- Aplikuesi/subjekti duhet të aplikojë vulosjen e vezëve për treg.

**Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Kopja e dëshmisë për numrin dhe origjinën e zogjve një ditë për pula vojse ose të pulave vojse, fatura e furnizimit nga importuesi dhe prodhuesi;
- Certifikata shëndetësore-veterinare e lëshuar nga Praktikant Veterinare të licencuara nga AUV;
- Dëshmia-vërtetimi nga veterinarin për aplikimin e programit të vaksinimit;
- Dëshmia se aplikon vulosjen e vezëve për treg.